



OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** i Departamenti të Marrëdhënieve me Klientin / Sektori i Verifikimit të Shërbimit të Klientit.

SPECIALIST

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Specialisti i Verifikimit ka për detyrë të mbikqyrë cilësinë e punës, të trajnojë, orientojë dhe të asistojë gjithë strukturat e verifikimit të shërbimit të klientit në lidhje me realizimin brenda kuadrit rregullativ përsa i takon:

- Procesin e verifikimit sipas problematikave të veçanta Kontraktuale, Mbifaturimit , Faturimit Afrofe, Teknike, etj në koordinim me njësitë e tjera të OSHEE.sha dhe në veçanti: Njësinë teknike –Njësinë e menaxhimit të kontratave dhe verifikimit të leximeve.
- Procesin e përpilimit të Akt-Konstatimeve për evidentimin e Identifikimin e klientëve, ID, Adresa, Matësve, Vulave e të tjera sipas natyrës së kërkesa/ankesave.
- Të kontrollojë saktësinë, plotësinë gjatë punës në lidhje me procesin e Verifikimit të Klientit dhe llojit të Shërbimit.
- Të kontrollojë Akt-Konstatimet dhe ti transmetojë te sporteli përkatës për trajtim.
- Të aplikojë procedurat në fuqi në lidhje me kërkesat për shërbime të klientëve duke përgatitur dokumentacionin përkatës.
- Të operojë me saktësi dhe shpejtësi në programet me të cilat do të punojë.
- Të transferojë informacionin për trajtim te njësitë përkatëse të OSHEE.sha.
- Të zbatojë rregullat e disiplinës në punë dhe të gjitha detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendëshme të Shoqërisë.
- Të bëjë azhurnimin në Database.
- Detyra të tjera që lidhen me klientin.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.
Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.